

ÇËSHTJA E KUFIJVE SHQIPTAR NË KONFERENCËN E AMBASADORËVE NË LONDËR MË 1912/13

Gazmend Rizaj

Fakulteti Filozofik

Prishtinë

KUD 949.65"1912/13":341-222

Punim studimor

Marrë për botim, më 5. III. 1996.

Konferenca e Ambasadorëve në Londër ishte organizuar në rend të parë për t'i zgjidhur problemet që dolën nga Lufta e Parë Ballkanike. Çështja shqiptare zinte padyshim vendin kryesor në këtë Konferencë. Meqenëse Fuqitë e Mëdha që e organizuan këtë Konferencë ishin të ndara në dy blloqe politike antagomiste, nga Konferenca e Londrës vështirë se mund të pritej ndonjë zgjidhje fatlume e problemeve ekzistuese. Kjo do të vërtetohet sidomos në çështjen shqiptare e cila në Konferencë u shqyrtua nga disa aspekte: nga aspekti i statusit të Shqipërisë; nga aspekti i organizimit shtetëror dhe nga aspekti i cakimit të kufijve të Shqipërisë me shtetet fqinje.

Çështja e kufijve të Shqipërisë, veçmas i kufirit verior dhe verilindor do t'i shkaktojë kokëçarje të mëdha diplomacisë së Fuqive të Mëdha disa muaj rresht.

Që në fillim të Konferencës makineritë e njohura propagandistike të qeverive serbe, greke e malazeze u riaktivizuan me hovë të madh për ta bindur opinionin evropian, e më tepër qarqet diplomatike, se kërkesat e tyre për zgjerim territorial në tokat shqiptare kinse kishin mbështetje historike, etnike, kulturore, morale, civilizuese etj., duke përdorur kështu falsifikime historike dhe kualifikime nënvleftësuese për popullin shqiptar¹. Qeveria e Përkohshme e

¹ Public Record Office-Foreign Office (në vazhdim-PRO-FO), Londër, 424/241, 4032, doc.nr.5-Informatë e Edward Grey-it, 21.I.1913; Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit*, II, Tiranë, 1978, dok.nr.4 dhe 5, f.197-217.

Vlorës, e cila në kohën e thirrjes së Konferencës pushtetin e vet e shtriente në një zonë shumë të ngushtë (pos Vlorës mbante vetëm Fierin, Lushnjën, Beratit e Gjirokastrën), e ngarkoi një delegacion qeveritar (Mehmet Konica, Rasim Dino dhe Filip Noga) për të shkuar në Londër dhe për t'i paraqitur kërkesat e Qeverisë shqiptare lidhur me kufijtë e Shqipërisë por edhe që t'i kundërvijet me argumente të fuqishme propagandës serbe e greke². Mirëpo, kërkesat dhe argumentet e delegacionit shqiptar, përkundër rëndësisë së tyre nuk arritën të bënin ndonjë ndikim të madh në politikën ballkanike të Fuqive të Mëdha, konturat themelore të së cilës ishin determinuar qysh më parë.

Qysh në mbledhjet e para të Konferencës, siç dëshmojnë procesverbalet dhe raportet e shumta të ambasadorëve të Fuqive të Mëdha dukej qartë se integriteti i tokave shqiptare, për çka angazhim më të madh tregoi Austro-Hungaria, ishte hiç më tepër se një dëshirë e dënuar *a priori* me dështim. Kjo u vërtetua që në fillim të Konferencës, me rastin e bisedimeve që ambasadorët zhvilluan rreth kritereve që do të shërbenin si bazë për caktimin e kufijve. Kriteri etnik që shkonte në favor të çështjes shqiptare ra nën hijen e parimit të "së drejtës së fituesit në luftë". Në të vërtetë Austro-Hungaria dhe Italia si më të interesuarat për krijimin e një Shqipërie të pavarur dhe "viable", si pandan e cekën çështjen e unitetit kombëtar shqiptar, si mënyrë e vetme që një Shqipëri e ardhshme të jetë e aftë të ekzistojë e pavarur. Mirëpo, ata njëkohësisht ishin të vetëdijshëm se parimit të së drejtës së pushtuesit domosdo i duhej lëshuar pe.

Nga dhjetori i vitit 1912 e deri më 22 mars 1913 në Konferencë u shqyrtua vetëm çështja e kufijve veriore dhe veri-lindorë të Shqipërisë, ndërkaq kufiri jugor u shtrua nga 19 marsi e deri më 11 gusht 1913. Mali i Zi me çdo kusht pretendonte Shkodrën, kurse Serbia krahas pretendimit për fitimin e një limani shqiptar në Adriatik, kërkonte Kosovën, Rrafshinë e Dukagjinit (Pejën, Prizrenin, Gjakovën) si dhe pjesën e Maqedonisë shqiptare, në veçanti Dibrën³. Me këtë rast duhet nënvizuar se territoret shqiptare të ish-Vilajetit të Kosovës, me përjashtim të qyteteve të Rrafshit të Dukagjinit (Pejës, Prizrenit e Gjakovës) shumë pak apo fare nuk u diskutuan në Konferencë. Në të vërtetë nga vet propozimi i vijës kufitare si nga Austro-Hungaria ashtu edhe nga Rusia që iu prezentuan Konferencës në dhjetor 1912 u pa se Kosova dhe pjesa më e madhe e Maqedonisë shqiptare ishin shlyer si çështje diskutuese. Kështu projekti fillesat austro-hungarez i dhjetorit 1912 brenda kufijve të Shqipërisë përfshinte krahas Shkodrën në veri e Janinën në jug edhe të gjitha qytetet e Rrafshit të Dukagjinit, pastaj Dibrën dhe Liqenin e Ohrit. Ndërkaq, projekti rus e kishte cunuar aq shumë Shqipërinë sa që jashtë saj i kishte lënë krahas

² *Qeveria e Përkohëshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, nëntor- 1912-janar 1914*, Tiranë, 1963, f. 98-100.

³ *Historia e popullit shqiptar*, II, Tiranë, 1965, f.366.

qytetve dhe vendeve diskutabile, edhe Kukësin, Pogradecin, Korçën, Delvinën, Sarandën e Janinën⁴. E. Grei, si kryesues i Konferencës me të njohtuar me përmbajtjen e këtyre dy projekteve mbajti një qëndrim të rezervuar. Në fillim të dy propozuesit e projekteve kufitare ishin kategorik në qëndrimet e tyre, por siç do të vërtetohet më vonë të dy palët do të lëshojnë pe, por Austro-Hungaria shumë më tepër.

Qeveria serbe ishte e vetëdijshme se pa pajtimin e Austro-Hungarisë nuk mund ta realizojë ëndrrën e saj për dalje në Adriatik përmes një porti shqiptar. Këtë fakt e ilustron mjaft bindshëm njëri ndër shumë raportet konfidenciale të ambasadorit anglez në Beograd, i cili në fund të dhjetorit 1912 e informonte Forin Ofisin se Nikolla Pashiqi i kishte ofruar Berhtoldit koncesione të konsiderueshme ekonomike në rast se Austria miraton propozimin që Serbia ta fitojë një liman në detin shqiptar⁵. Konti Berhtold e kishte refuzuar këtë propozim, madje edhe vet çështja e limanit me kohë mbeti vetëm si qëndrim deklarativ i Konferencës, meqë realizimi i saj ishte mjaft problematik. Tërheqja e Serbisë, përkatësisht e Rusisë nga ky pretendim tërhiqte pas vetës kërkesën eksplicite që në emër të kompensimit nga kjo tërheqje të përmbushen kërkesat serbe mbi korrigjimin e kufirit veri-lindor të Shqipërisë⁶, që e kishte propozuar Austro-Hungaria.

Për Serbinë rëndësi të dorës së parë kishte Prizreni dhe Peja, ndërkaq për Dibrën dhe Gjakovën në fillim interesimi ishte më i vogël. Mirëpo, nga një bisedë zyrtare që ambasadori italian e kishte zhvilluar me E.Grein më 31.XII.1912, shohim se vet Rusia ishte ajo forcë shtytëse që e inicone kërkesën serbe për Gjakovën, të cilën pastaj do ta përdorte si mallë shkëmbyes. Kështu, sipas planeve ruse, konstatonte ambasadori italian, marrëveshja mund të arrihet vetëm atëherë nëse Austria heq dorë nga Shkodra, me ç'rast edhe Rusia do të heqte dorë nga Gjakova⁷.

Edhe pse e interesuar që Shqipërisë t'i takojnë sa më shumë territore etnike, megjithatë luhatja e qeverisë austro-hungareze u vërejt që në ditët e para të janarit 1913. Kjo dëshmohet, pos tjerash, sidomos nga vizita që konti Trotmensdorf ia bëri Lordit Onslou në Forin Ofisin britanik. Në bisedë e sipër përfaqësuesi austro-hungarez kishte theksuar se austriakët janë kategorik që Gjakova, Dibra dhe Shkodra të përfshihen në Shqipëri, kurse sa i përket Pejës e Prizrenit, ai kishte thënë se, kjo do të jetë temë e hapur për bisedime⁸.

⁴ *Po aty*.

⁵ PRO-FO, 424/241, 4032, doc.nr.118-Raport i R.Paget-it, 28.XII.1912.

⁶ PRO-FO, 424/241, 4032, doc.nr.118-Raport i R.Paget-it, 31.XII.1912; *Po aty*, doc.nr.20-Informatë e Edward Grey-it, 14.I.1913; PRO-FO, 424/242, doc.nr.26-Raport i Berclay-it, 14.II.1913.

⁷ PRO-FO, 424/236, 4032, doc.nr.308-Informatë e Edward Grey-it, 31.XII.1912.

⁸ PRO-FO, 424/241, 4032, doc.nr.5-Informatë e Edward Grey-it, 9.I.1913.

Edhe pse në vijim kishte potencuar se këto ishin qytete etnikisht të pastërta shqiptare, megjithatë mënyra dhe toni i bisedës simptomatizonte luhatjen e parë të Austro-Hungarisë.

Lidhur me vijat kufitare të propozuara nga Austro-Hungaria dhe Rusia vlen të theksohet se rusët i kishin propozuar luginat dhe lumenjt si kufij ndarës, ndërkaq, austriakët ishin të interesuar për bjeshkë. Këtë e kishin propozuar, për arsye se, siç thonin ata, "*nëse kufiri gjendet në majë të bjeshkës, kjo do të ishte barikadë më efektive ndërmjet banorëve nga të dy anët sesa kufiri të gjendet përgjatë luginës.*"⁹

Si përfaqësues i një Fuqie të rëndësishme dhe nikoqir e kryesues i Konferencës së Ambasadorëve E. Grei padyshim e luante një rol me rëndësi në përcaktimin e kaheve të Konferencës. Edhe pse mundohej të ishte sa më i paanshëm, së paku deklarativisht, E. Grei si diplomat me përvojë të gjatë ishte i vetëdijshëm se intransigjenca austriake rreth çështjes së Shkodrës ishte e pathyeshme, prandaj ndikimin e vet diplomatik e orientoi nga zgjidhja e drejtë e çështjes së Shkodrës e për pikat tjera diskutabile, siç do të shohim, qëndrimi shkoi në drejtim tjetër. Qëndrimin e E. Greit ndaj çështjes së Shkodrës shumë mirë e ilustron një takim zyrtar i tij me ambasadorin rus Bekendorf dhe atë francez, Kambon më 14 janar 1913¹⁰. Ndër të tjera, duke mos i marrë si serioze "argumentet" që këta dy ambasadorë ia prezentuan lidhur me Shkodrën, E. Grei, (duke iu referuar ekskluzivisht burimeve të sigurta informative angleze) ishte kategorik se kërkesa e Malit të Zi për Shkodrën ishte e paarsyeshme "*sepse Shkodra është qytet i pastër shqiptar*"¹¹. Mirëpo, ambasadori rus pasi u detyrua të pranojë këtë fakt, kishte theksuar se Rusia do të heqë dorë nga Shkodra, por ajo duhet ta kënaq kërkesën serbe lidhur me kufirin lindor të Shqipërisë¹². Në vijim të bisedës E. Grei po ashtu kishte theksuar se disa qytete (si shembull e merr Gjakovën) të cilat i kërkonte Serbia ishin vende shqiptare¹³. Ambasadori rus duke mos ditur si t'i përgjigjej Greit ishte munduar të japë një shpjegim sa të pasakt aq edhe qesharak. Në të vërtetë, ambasadori rus, kishte pohuar me atë rast se në territorin e Shqipërisë kinëse ekzistonin katër raca: "*se kishte serbë të vërtetë dhe shqiptarë të vërtetë, dhe serbë të rrejshëm e shqiptarë të rrejshëm. Numri i popullsisë që veten e quajnë shqiptarë në të vërtetë nuk ishin shqiptarë të vërtetë dhe se në vendet siç ishte Gjakova, gjuha në përdorim ishte serbishtja*". Vërtetë një konstatim i këtillë nga aspekti shkencor nuk vlen të komentohet, bile edhe vet E. Grei në raportin e vet zyrtar nga kjo bisedë nuk e kishte pa të udhës t'i komentojë

⁹ Po aty.

¹⁰ PRO-FO, 424/241, 4032, doc.nr.20-Informatë e Edward Grey-it, 14.I.1913.

¹¹ PRO-FO, 424/242, doc.nr.101-Informatë e Edward Grey-it, 6.II.1913.

¹² Po aty.

¹³ Po aty.

shpjegimet absurde dhe konfuze të ambasadorit rus. E. Grei bisedën e kishte përfunduar me konstatimin se do të ishte e paarsyeshme që të shpërthente lufta ndërmjet Rusisë dhe Austro-Hungarisë për arsye se a do të fitojë Serbia disa kilometra katror më shumë a më pak¹⁴.

Përkundër luhatjes së caktuar të Austro-Hungarisë rreth disa pikave, megjithatë bisedimet mbi kufirin verior dhe verilindor të Shqipërisë pothuaj nuk lëvizin nga pika e vdekur. Në ndërkohë fuqitë e Antantës tërhoqën një potez të ri diplomatik. Të vetëdijshëm se tehu i intransigjencës austro-hungareze rreth pikave kryesore diskutabile mund të topitej më së miri nga brenda, ata ia besuan Gjermanisë hartimin e një projekt-propozimi të ri të kufirit në veri dhe në lindje¹⁵. Projektin e ri kufitar e hartoi ambasadori gjerman Lihnovski, të cilin në emër të Aleancës Tripalëshe ia prezentoj Konferencës më 6 shkurt 1913. Sipas projektit të Lihnovskit kufiri do të nisej nga Adriatiku dhe të ndiqte rrjedhën e Bunës deri në pikën që ndodhet midis Rushkullit dhe Samrshit, pastaj do të drejtohej drejt Liqenit të Shkodrës duke ia lënë Taraboshin Shqipërisë, do të përshkonte liqenin deri te gjiri i Liqenit të Hotit dhe do t'i linte Malit të Zi Hotin e Grudën, ndërsa Shqipërisë do t'i mbeteshin Kastrati, Kelmendi dhe Shkreli. Plava, Gusia, Peja dhe manastiri i Deçanti do të mbeteshin jashtë Shqipërisë si dhe Prizreni me përjashtim të territorit të Lumës. Gjakova dhe Dibra do të qëndronin në Shqipëri, pastaj kufiri do të kalonte në anën e majtë të Drinit për njëfarë gjatësie deri në liqenin e Ohrit¹⁶. Lihnovski kishte deklaruar se këtë vijë kufiri ai e ka studiuar së bashku me ambasadorin e Austro-Hungarisë dhe po e paraqitte në formën e një kompromisi¹⁷. Konti Mensdorf, ambasador austro-hungarez në Konferencën e Londrës, kishte deklaruar se vetëm dëshira për të arritur një zgjidhje me lëshime nga "të dyja palët" e ka shtyer atë të bashkohet me këtë projekt, madje edhe këtë e bënte pa vullnet¹⁸.

Kundërpropozimi i Rusisë i 13 shkurtit 1913 parashihte që kufiri të ndiqte rrjedhën e Bunës, ashtu që gjithë Liqeni i Shkodrës t'i takojë Malit të Zi, ndërkaq, Gjakova Serbisë; pastaj kjo vijë do të ndiqte Drinin duke ia dhënë Dibrën Serbisë¹⁹. Në kontekst me këtë propozim, ministri rus Sazanov e kishte njohtuar ambasadorin francez Kambon, se do të pranonte pa hamendje që Gjakova t'i mbete Shqipërisë, po që se Austria do të lëshonte pe në pikat tjera²⁰.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ A. Puto, *Vep. cit.*, dok.nr.9, ff.225-226.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Po aty, dok.nr.10, ff.226-227; PRO-FO, 424/242, doc.nr.75-Informatë e Edward Grey-it, 15.II.1913.

²⁰ Po aty.

Pra, gjatë muajve janar-shkurt 1913 lufta më e madhe diplomatike u zhvillua sidomos për Shkodrën, Gjakovën e Dibrën ndërkaq Prizreni dhe Peja gradualisht kishin dalur nga "kombinimet kryesore". Mirëpo, nuk kaloi shumë kohë e tripalëshi u detyrua të lëshojë pe edhe për Dibrën. Kështu, ambasadori austro-hungarez më 20 shkurt 1913 ua komunikoi ambasadorëve tjerë qëndrimin e Berhtoldit, se ai do të pajtohet që Dibra të mbetet jashtë Shqipërisë. Ambasadori austro-hungarez po ashtu kishte bërë njoftim se qeveria e tij, falë presioneve të vazhdueshme, mund të heqë dorë nga Prizreni, Peja dhe Dibra, por kurrsesi edhe nga Shkodra dhe Gjakova²¹. Porse, insistimi i qeverisë që t'i takojë edhe Gjakova ishte aq kategorik sa që kishte filluar t'i shkaktojë kokëçarje edhe vet kryesuesit të Konferencës Eduard Greit. Ky në një bisedë kinfidenciale me të ngarkuarin e Ministrisë së Punëve të Jahtme të Serbisë, më 4 mars 1913, i kishte thënë pos tjerash se, disa javë rresht kishte shfrytëzuar çdo mundësi diplomatike që t'ia sigurojë Serbisë katër vende: Prizrenin, Pejën, Gjakovën e Dibrën. Gjithashtu e kishte bërë me dije se *"nëse pjesa më e madhe e këtij qëllimi është arritur me mjete diplomatike atëherë do të ishte e tepërt që Evropa të hyjë në luftë për një apo dy vende që nuk kanë mundur t'i sigurohen Serbisë me mjete diplomatike"*²². Grei pastaj e kishte këshilluar përfaqësuesin serb se kokëfortësia serbe, jo vetëm që mund ta implikojë ndërprerjen e Konferencës, por edhe që në rast konflikti me Austrinë ajo do t'i rrezikonte pa nevojë të gjitha përfitimet territoriale²³.

Në mbledhjen e 6 marsit ishte vendosur mbi të gjitha pikat diskutabile. Në të vërtetë, fuqitë praktikisht ishin marrë vesh që Peja, Prizreni dhe Dibra të mbesin jashtë Shqipërisë, ndërkaq Shkodra t'i mbetet Shqipërisë. Vetëm çështja e Gjakovës mbeti e hapur. Mirëpo duke qenë e shqetësuar për fatin e Shkodrës, që rrezikohej të binte në duart e ushtrive malazeze e serbe por edhe nën presionin e vazhdueshëm të Fuqive të Antantës, e hiç më pak edhe të aleatëve të vet Tripalësh (Gjermani dhe Italia), Qeveria austro-hungareze u detyrua të lëshojë pe edhe për Gjakovën. Kështu, nga nota e ambasadës së Austro-Hungarisë në Paris, të datës 21 mars 1913²⁴ njoftohemi mbi qëndrimin definitiv të Qeverisë austro-hungareze lidhur me kufijtë veriorë e verilindorë të Shqipërisë. Në këtë notë theksohej me sa vijon: *"Të përfundohet sa më shpejt caktimi i kufijve të Shqipërisë dhe të sigurohet pa vonesë largimi i trupave aleate nga ky vend."*

²¹ PRO-FO, 424/242, doc.nr.168-Informatë e Edward Grey-it, 20.II.1913.

²² Po aty, doc.nr.21-Informatë e Edward Grey-it, 4.III.1913.

²³ Po aty.

²⁴ Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare ...*, II, dok.nr.12, ff.228-229.

Fuqitë e Mëdha të marrin përsipër të sigurojnë mbrojtjen efektive të popullsisë shqiptare me fe myslimane dhe katolike në territoret që do të kalojnë nën sundimin serb ose malazias.

Në këto kushte konti Berhtold do të hiqte dorë nga dëshira e tij për t'ia lënë qytetin e Gjakovës Shqipërisë.

Ky lëshim kushtëzohet me zotimin e qeverive të tjera që kufiri verior dhe verilindor i Shqipërisë, edhe për sa i përket Bunës dhe Liqenit të Shkodrës, do të rregullohet sipas dëshirave të njohura të Austro-Hungarisë.

Pushimi i menjëhershëm i veprimeve luftarake dhe zbrazja e shpejtë e territorit shqiptar nga aleatët do të kërkohet dhe do të sigurohet nga përfaqësuesit e Fuqive në Beograd dhe Cetinë.

Në qoftë se do të arrihet një marrëveshje në këtë drejtim, dërgimi i një komisioni ndërkombëtar në Gjakovë nuk do të ishte më i nevojshëm."²⁵

Qëndrimi i Austro-Hungarisë lidhur me Gjakovën u mirëprit nga ambasadorët, dhe së shpejti më 22 mars 1913 Konferenca e Ambasadorëve e aprovoi dhe e zyrtarizoi shkëputjen edhe të Gjakovës²⁶ e me këtë edhe të mbarë Rrafshit të Dukagjinit nga trangu kombëtar. Lidhur me këtë qëndrim të ambasadorëve, delegatët shqiptarë të Qeverisë së Vlorës, Mehmet Konica dhe Filip Noga në një takim me përfaqësuesin zyrtar të Forin Ofisit H. C. Norman më 26 mars 1913, ia kishte shprehur pikëpamjen shqiptare lidhur me situatën më të re. Ata shprehën indinjatën e thellë lidhur me qëndrimin e fundit të ambasadorëve duke vënë në pah se "*çështja Shqipërisë po zgjidhej pa i përfillur fare shqiptarët dhe se kufijt e vendit po përcaktoheshin vetëm sa për të parandaluar një prishje midis Austro-Hungarisë dhe Rusisë. Duke ia caktuar Gjakovën Serbisë, vazhduan delegatët shqiptarë, jeta do të bëhet e pamundur për banorët e Shqipërisë Veriore, sepse atyre tani u mbetej vetëm një vend malor dhe joprodhues që varej nga Gjakova për mjetet elementare të jetesës. Kjo mënyrë e zgjidhjes do ta bëjë të pamundur çdo lloj paqeje në këtë anë". Ata gjithashtu shprehën frikën se "e njejtat gjë do të ndodhë edhe në jug, ku fusha në jug dhe në përfundim të Janinës ka të njejtat lidhje me pjesën tjetër të vendit si ajo e Gjakovës në veri. Grekët e kishin pushtuar këtë krahinë duke u shtrirë deri në Vlorë dhe natyrisht do të përpiqen ta mbajnë"²⁷.*

Me këtë konstatim të delegatëve shqiptarë në Londër, po lidhemi me çështjen e kufirit jugor të Shqipërisë, e cila fillohet diskutohet në prag të përfundimit të çështjes së kufijve veriorë e verilindorë të Shqipërisë. Edhe fazën e dytë të traktativave kufitare, që kishin të bënin me kufirin jugor, do të thotë

²⁵ *Po aty.*

²⁶ PRO-FO, 424/243, 4216, doc.nr.50-Informatë e Edward Grey-it, 6.III.1913.

²⁷ PRO-FO, 424/243, 4216, doc.nr.507-Shënime nga Zot. H. C. Norman, Foreign Office. Londër, 26.III.1913.

kufirin midis Shqipërisë dhe Greqisë e përshkon fryma e ngajshme e pazarllëqeve me territoret shqiptare. Në të vërtetë, Austro-Hungaria dhe Italia ishin ngarkuar nga Konferenca që së bashku ta hartonin projekt-propozimin e kufirit shqiptaro-grek. Ata hartuan dy projekte të tilla (të parin më 19 mars, të dytin më 2 maj 1913). Në mënyrë kategorike kërkohet që Korça dhe Gjirokastra t'i mbesin Shqipërisë, por edhe që Greqisë mos t'i takoj gjithë bregdeti përballë Korfuzit.

Sipas këtyre projekteve vija e kufirit do të nisej nga Liqeni i Prespës dhe do të dilte në detin Jon, në derdhje të lumit Kallamas. Greqia, e përkrahur në mënyrë të veçant nga Franca, e bile në këtë pikë edhe nga Gjermania, kërkonte që bregdeti përballë Korfuzit të përfshihej brenda kufijve të Greqisë. Mirëpo, këtë e kundërshtoi kategorikisht Italia, e cila këtu shikonte rrezikun e krijimit të një baze të madhe detare në ujërat e kanalit të Korfuzit, gjë që prekte interesat e saj strategjike në këtë zonë. Italia madje këtij plani iu kërcnua edhe me përdorimin e forcës së armëve. Kjo shkaktoi një tensionim të atmosferës në Konferencë. Por vetë Italia, për ta lehtësuar arritjen e një marrëveshjeje, propozoi si kufi në bregdet, jo derdhjen e lumit Kallamas, por kepin Stillo përballë Korfuzit²⁸.

Marrë në tërësi, edhe projekti i parë edhe ai i dytë nuk u realizuan ashtu siç e menduan Austro-Hungaria dhe Italia, përkundrazi ato lëshuan pe dhe u tërhoqën nga pozita e tyre fillestare, duke e lënë Janinën në brendësi, ndërkaq, në bregdet e ngjitën lartë dy herë vijën e propozuar. Lufta e dytë ballkanike në një mënyrë ndikoi që marrëveshja rreth caktimit të kufirit shqiptaro-grek të përfundojë më shpejtë. Kështu, pengesat e fundit u kapërcyen me një formulë të pranueshme për të gjitha palët dhe më 11 gusht u arrit marrëveshja përfundimtare, sipas së cilës Korça, rripi bregdetar deri në Ftelia dhe ishulli i Sazanit i mbeteshin Shqipërisë²⁹, por e tërë Çamëria iu shkëput trungut kombëtar.

Zgjidhja e çështjes së kufijve shqiptarë, siç e theksuam më lartë, nuk ka mundur të përfundojë në mënyrë fatlume për çështjen shqiptare në përgjithësi. Nga mesi i shumë faktorëve që e përcaktuan këtë rrjedhim dy ishin dominant: faktori i parë lidhet me raportin e forcave që ishte në dëm të çështjes shqiptare, ndërsa faktori i dytë ishte i lidhur me logjikën e rrethanave të kohës, sipas së cilës më shumë çmohej parimi i fituesit në luftë se sa parimi etnik, demografik, historik etj. Kur përmendëm faktorin e parë, domosdo imponohen pyetje dhe analogji me situatat e mëvonshme të historisë sonë kombëtare. Në kontekstin e kohës, kur vendosej mbi ardhmërinë e tokave shqiptare, fatkeqësisht populli shqiptar nuk e kishte as forcën ushtarake që t'u kundërvihej me sukses planeve hegjemoniste të fqinjve ballkanikë, por nuk kishte e as miq

²⁸ A. P u t o, *vep.e cit.*, II, ff.74-78.

²⁹ *Po aty*, f.79.

të tillë që të ishin deri në fund të vendosur për ruajtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë. Roli i Tripalëshit, në veçanti roli i Austro-Hungarisë ishte padyshim shumë i rëndësishëm, mirëpo duhet theksuar se në rrethanat e kohës ato nuk ishin të gatshme që, për hirë të integritetit të tokave shqiptare, të konfrontoheshin ushtarakisht me Antantën dhe ta shkaktojnë ndërprerjen e Konferencës. Të gjitha traktativat kufitare me një fjalë u zhvilluan në frymën e kompromisit. Prandaj, tërheqjen e Austro-Hungarisë nga projekti i vet fillestar i kufijve të Shqipërisë nuk duhet shikuar nga prizma emotive, por si një veprim të natyrshëm të kushtëzuar nga rrethanat e shumëduarshme, sepse miq të vërtetë në diplomaci nuk ka. Ekziston vetëm interesi si mjet determinues i çdo aleance dhe bashkëpunimi.

Konferenca e Ambasadorëve në Londër, sikurse edhe Kongresi i Berlinit, u bë kështu instrument justifikues i vazhdimit të copëtimit të truallit etnik shqiptar. Përgjegjësia e Fuqive të Mëdha për një vend të tillë është e pakontestueshme dhe historikisht kurrë e vjetruar. Pasojat e vendimeve të padrejta që u morën më 1913 po ndjehen edhe sot, pas plotë 82 vitesh dhe atë në formën e vet më të vrazhdët. Mirëpo, në këtë aspekt duhet vënë në pah se përgjegjësia historike domosdo bie edhe mbi faktorin e brendshëm shqiptar, i cili si pasojë e përçarjes klasore e ideologjike, pastaj papjekurisë dhe mosgjeturisë së duhur, nuk arriti të dalë para diplomacive evropiane si një trup homogjen dhe i vendosur deri në fund për ruajtjen e tërësisë së territoreve etnike. Ndoshta në këtë aspekt nuk do të arrihej shumë, por së paku do t'i shmangeshim barrës së përgjegjësisë. Prandaj, çdo tentim që përgjegjësia *a priori* t'u mëvishet vetëm Fuqive të Mëdha do të na shpiente nga sindromi i vjetër ballkanik mbi fajësinë ekskluzive të faktorëve të jashtëm pa e parë edhe vetveten në atë mes.

Shqiptarët me historin e tyre të pasur përherë iu referuan të kaluarës së vet historike, si mësim për të ardhmën. Shpresoj se së shpejti do të vijë dita që fëmijët dhe nipat tanë të kaluarën e lavdishme, por edhe të hidhur, ta mësojnë më shumë si lëndë mësimore sesa si mësim jete.

Gazmend Rizaj

THE QUESTION OF THE ALBANIAN BORDERS IN THE LONDON AMBASSADORIAL CONFERENCE IN 1912/13

S u m m a r y

The Conference of Ambassadors in London, like the Congress of Berlin was made a justifying instrument of continuation of the partition of the Albanian ethnic territories (lands). Responsibility of the six Great Powers for such decision (with

